

Regjistri i ankimeve/denoncimeve 2018

Nr.	Data e regjistrimit të ankesës	Objekti/ Të dhëna mbi subjektin e denoncuar	Sektorit që i drejtohet	Statusi i ankesës dhe data e kthimit të përgjigjes	Tarifat
1	09.01.2018	Subjekti : tregtim produkte shtazore (peshk) Qarku: Lushnje Adresë: Rreth rrotullit Cermes Përshkrimi: Tregtim në kushte të papërshtatshme	DRAKU Fier	Vijon monitorimi per konstatimin e qytetarit	Pa Tarifë
2	30.01.2018	Denoncim për therjen e kafshëve në kushte te papërshtatshme ne Lushnje Adresa: Kryqëzimi tek Stadiumi	DRAKU Fier	Vijon monitorimi per konstatimin e qytetarit	Pa Tarifë
3	21.02.2018	Subjekti: Kioskë Adresa: prane shkollave Gustav Mayer dhe Naim Frasherit, ne kryqezimin e rruges Ndre Mjeda me rrugen Frosina Plaku (nga ana e marketit Conad). Tregtim i produkteve (molto) kushte të papërshtatshme, dt. e skadencës fshihet lehtë	DRAKU Tiranë	Trajtuar datë: 22.02.2018 OBU ushtron aktivitet ne nje kioske te vendosur nga Bashkia; - Kushtet higjeno sanitare jane te mjaftueshme; - Subjekti Tregton produkte te ambalazuara brenda afatit te perdorimit; - Disponon dokumentacion shoqerues, etiketimi i produkteve te importit ne gjuhen shqipe - Gjurmuesheria- zbaton ne baze te faturave tatimore - Mungon plani 3 D - Librezat shendetesore te personelit jane ne procedure rinovimi Masa administrative me Paralajmërim dhe Korigjim te detyrave te lëna brenda nje afati kohor prej 30 ditesh.	Pa Tarifë
4	26.02.2018	Subjekti: Firma Fix, Lux i shijes Adresa: Fier. Data e skadencës fshihet lehtë	DRAKU Fier	Trajtuar datë: 28.02.2018 Nga kontrolli i kryer rezultoi se ky subjekt (OBU) ushtron aktivitetin tregtar të produkteve ushqimore konform rregullave ligjore.	Pa Tarifë
5	05.03.2018	Subjekti: supermarketi KMY adresa : prane 21 Dhjetorit (Te kryqezimi Myslym Shyrit) Dyshimi se tregtohen produkte te skaduara, jashtë afatit të përdorimit	DRAKU Tiranë	Trajtuar datë: 05.03.2018 Nga inspektimi i bere nga trupa inspektuese nuk u konstatua tregtim te produkteve ushqimore me afat përdorimi te kaluar.	Pa Tarifë
6	08.03.2018	Adresa : Zona Kutallise, ne qender te Drenovices, ne qytetin e Beratit. Shitjen e produkteve ushqimore (produkte kryesisht per femije) ne kushte te papershtatshme (ne rruge).	DRAKU Berat	Trajtuar Datë: 13.03.2018 U krye monitorimi pranë shkollës 9 vjecare “Zenel Zeka” dhe nuk u konstatuan tregtues të produkteve ushqimore me tavolina. Nga kontakti që patëm me përfaqësues të shkollës na u komunikua se pranë derës kryesore hyrëse të shkollës nuk ka tavolina që tregtojnë produkte ushqimore. U krye verifikim i gjithë zonës së përshkruar nga denoncuesi dhe nuk u konstatuan shitës ambulant. Gjithashtu u krye një takim me administratorin e Njësisë administrative Kutalli i cili na komunikoi se në zonën e Qëndër, Drenovicë nuk ka shitës ambulant.	Pa Tarifë
7	16.03.2018	Subjekti: Supermarketi "Eco market". Adresa ne zonen e porcelanit (lagjia Varri Bamit), ne Tirane. Denoncim i ardhur per nje produkt te mykur (produkti gjalp), por qe eshte brenda dates se skadences (sipas paketimit).	DRAKU Tiranë	Trajtuar Datë: 26.03.2018 U krye inspektimi subjektit nga trupa inspektuese e DRAKU Tirane me date 19.03.2018. Gjate inspektimit nuk u konstatuan probleme ne kushtet e ruajtjes se produkti, u hapen disa pako gjalpi dhe nuk konstatuan prani myku. Megjithatë u moren mostra per tu analizuar ne laborator per prani myku dhe analiza bakterologjike (E. Coli). Ne pergjigjen e raportit te proves dt.21.03.2018 analiza bakterologjike per E. Coli rezultoi brenda normave. Ne pergjigjen e raportit te proves dt.21.03.2018 analiza fiziko kimike, per prani myku, rezultoi pa shenja myku.	Pa Tarifë
8	19.03.2018	Denoncim per produktin mish (ka dërguar foto, qese mishi në rrugë). Mungojnë të dhënat .	DRAKU Tiranë	Qytetari nuk ka derguar te dhena me sqaruese te rastit	Pa Tarifë
9	19.03.2018	Adresa: Kamez Tirane. shitjen ne kushte te papershtatshme (ne rruge) te produktit peshk.	DRAKU Tiranë	Trajtuar Datë: 23.03.2018 Datë 22.03.2018 u krye inspektim ne kete zone duke bashkëpunuar edhe me policinë Bashkiake të Kamzës. Gjate inspektimit nuk u konstatua tregtim te peshkut ne rruge me karroca apo ndonjë makine qe tregtonte peshk ne ambient te hapur. Monitorimi i këtij tregu do vazhdoje edhe ditët e pushimit (Të shtunën dhe të dielën)	Pa Tarifë

10	26.03.2018	Adresa: Komuna e Parisit, pas kafe Oslos (ky subjekt tregton prapa dyqanit te peshkut), Tirane Tregtimin e produkteve te bulmetit dhe fruta perimeve, ne kushte tërësisht jashtë standardeve.	DRAKU Tiranë	Trajtuar datë: 31.03.2018 Gjatë inspektimit u konstatuan mangësi për të cilat u morën këto masa: 1. Për mangësi ne etiketimin e produkteve ushqimore gjobe ne masën 50 000 leke. 2. Për mangësitë e tjera ju dha masa Paralajmërim.	Pa Tarifë
11	27.03.2018	Adresa: Drenovice Berat Shitjen e produkteve ushqimore nga ambulancet ne kushte te papërshtatshme.	DRAKU Berat	28.03.2018 Në vijim të verifikimeve lidhur me rastin e denoncimeve që vijnë nga banorë të fshatit Drenovicë, Njësia Administrative Kutalli, sot më datë 28.03.2018 DRAKU Berat në bashkëpunim me inspektorin e Njësisë administrative Kutalli z. Xhelal Vrapit ka bërë verifikime bazuar në informacionin e dhënë nga denoncuesi. Nga verifikimi për emrin e parë të përmendur nga denoncuesi “Azbi (biku) marina” nga jashtë murit rrethues të pronës private u vërejt një tavolinë e cila ndodhej në mes të oborrit të shtëpisë private përdhese dhe një fëmijë që mblodhi gjërat e ndodhura sipër saj dhe u fut në shtëpi. Nga kontakti që patëm me famijar të fëmijës na u deklarua se produktet nuk janë për tregtim por për konsum vetjak. Nga verifikimi për emrin e dytë të përmendur nga denoncuesi “luli shehu”, ky rast nuk u kontaktua dhe nga inspektori Njësisë administrative nuk ishte i njohur.	Pa Tarifë
12	29.03.2018	Adresa: subjektet prane shkolles 9- vjecare Sevasti Qirjazi, Korce. furrat e bukes qe sipas denoncuesit jane kthyer ne piceri apo fast-foode dhe tregtojne jashte kushteve higjieno-sanitare	DRAKU Korçë	Trajtuar datë: 06.04.2018 Inspektimi në Subjektin “Erion Qafzezi” me administrator Z. Erion Qafzezi, me NIPT/NUIS: L44203005P, aktivitet: “Njësi tregtimi dhe Fast-Food” dhe adresë:Lagja Nr. 2, rruga “Sotir Peçi, pranë shkollës 9 vjeçare ”Sevasti Qiriazit”, Korçë u krye me datë 30.03.2018 nga ku u konstatuan disa problematika ne lidhje me kushtet higjieno sanitare dhe gjurmuesmerise se produkteve ushqimore për te cilat subjektit iu dha masa administrative “Gjobjë” ne baze te legjislacionit ne fuqi.	Pa Tarifë
13	31.03.2018	Denoncim për lokalin AMED-ROS, Restorant-pasticëri ne adrese lagjia uji i ftohte ,rruga Murat Terbac, Vlore. Mungesë kushtesh higjieno-sanitare, uji.	DRAKU Vlorë	31.03.2018 Rasti eshte derguar me e-mail nga Drejtori I Pergjithshem per DRAKU Vlore. Nga verifikimet e AKU Vlore rezulton qe subjekti I ploteson kushtet higjieno sanitare, ka uje te ngrohte dhe te ftohte.	Pa Tarifë
14	01.04.2018	“Bar kafe Pisha” me vendodhje rruga Kalase ngjitur me "Hotel Panorama Kruje". Mungesë e kushteve higjieno-sanitare, dokumentacioni etj.	DRAKU Durres	Derguar nga Drejtori I Pergjithshem me e-mail per DRAKU Durres	Pa Tarifë
15	02.04.2018	Denoncim i ardhur ne lidhje me fshirjen e datës së skadences se produktit kikirikë. Sipas qytetarit, produkti vazhdon tregtohet edhe perse data e skadences ka kaluar. Adresa: Market "EVI" Qyteti Studenti Tirane.	DRAKU Tiranë	Trajtuar Datë: 05.04.2018 Për produktin kikirik Huligan 150 gr rezulton se në ambientin e tregimit u konstatua ky produkt i cili është me datë skadence 28.04.2018. OBU është furnizuar me këtë produkt për herë të fundit me datë 10.03.2018 sipas faturës Nr.serial 225996780 nga Global Logistic, si dhe nga verifikimi i produktit rezultoi që data e skadences nuk fshihet. Persa me larte, nga trupa inspektuese u mor vendimi: Bazuar në pikat 1,4,5 neni 48 të Ligjit nr.10433 dt 16.06.2011 “Per Inspektimin në R.SH” OBU i jepet masa administrative “Paralajmërim”, korigjimin e shkeljeve të konstatuara brenda një afati një javor ,OBU duhet të njoftojë pranë DRAKU Tiranë për korigjimin e tyre.	Pa Tarifë
16	03.04.2018	Adresa: Lagjia Nr. 9 , furra e bukes prane Muzeumit te Deshmoreve, nga mbrapa Farmacive, Durres. Denoncim ne lidhje me kushtet higjieno sanitare te nje furre buke ne qytetin e Durresit.	DRAKU Durres	Trajtuar datë: 13.04.2018 Nga inspektimi rezultoi se nuk kishte prani të insekteve të llojit furrtares dhe as të insekteve fluturuese. OBU-ja dispononte certikatë të shërbimit 3 D (Deratizim, dizinfektim dhe dizinspektim). OBU-ja dispononte leje mjedisore të dhënë nga QKL-ja. Ujit i rrjetit ishte i pashoqëruar me raport analizë. U mor masa administrative kryesore “Paralajmërim” dhe u la një afat për korigjimin e shkeljeve të konstatuara për të cilat subjekti detyrohet të njoftojë DRAKU-në brenda afatit të caktuar për korigjimin e mangësive të konstatuara.	Pa Tarifë
17	05.04.2018	Emri Subjektit: Zgara Tirones Adresa: Rruga e Kavajes, Tiranë Përshkrimi: Jemi helmuar me produktet e konsumuara Kategoria: Kushte Higjieno-Sanitare	DRAKU Tiranë	Trajtuar Datë: 14.04.2018 Nga inspektimi i kryer nuk u konstatuan mangësi ne kushtet higjieno-sanitare ne linjën e prodhimit te qofteve. Te vetmen mangesi qe kane konstatuar ka qene garderoba e papershtatshme dhe raport analizat per produktin djathë duhet rinovuar. U Moren mostra per 1 produkt qofte zgare. Per mangësitë e konstatuara ju dha masa PARALAJMËRIM. Rezultati i analizave për mostrën e marrë ka rezultuar brenda normave për E. Coli.	Pa Tarifë

18	05.04.2018	Emri Subjektit: Ervis Qazim . Qarku: Qarku i Tiranës Adresa: Rruga "Stavri themeli " Përshkrimi: Prodhim dhe shpërndarje produkte me origjinë shtazore në kushte skandaloze Kategorija: Kushte Higjieno-Sanitare	DRAKU Tiranë	Trajtuar datë 14.04.2018 Nga inspektimi i kryer nuk u konstatuan mangësi në kushtet higjieno sanitare në linjën e prodhimit të qofteve. Te vetmen mangësi që kane konstatuar ka qene, nuk janë përditësuar te dhënat në tabelat monitoruese të planit HACCP për datën 5 prill 2018. U Moren mostra për 3 produkte Pleskavice, qofte pule dhe Kernacka. Për mangësitë e konstatuara ju dha masa PARALAJMERIM. Rezultati i analizave për mostrat e marra kane rezultuar brenda normave për E. Coli për të tre produktet.	Pa Tarifë
19	05.04.2018	Emri Subjektit: Gentian Zerellari Qarku: Qarku i Tiranës Adresa: Rruga "Sali Butka " Përshkrimi: Disa fëmijë janë helmuar pasi kishin konsumuar produktet e prodhuara nga ky subjekt kemi dhe prova që te cilat do ti çojmë dhe me tutje.	DRAKU Tiranë	Trajtuar Datë: 14.04.2018 - Nuk kane konstatuar mangësi në kushtet higjieno sanitare në linjën e prodhimit të qofteve. - te vetmen mangësi që kane konstatuar ka qene : Ne hyrje te stabilimentit nje pjese e murit e pa lyster dhe mungon frigoriferi per mishin e pa pshrtetshme - Moren mostra për 4 produkte, Qofte Kacaku, Qofte shtëpije, Qofte me djathe dhe panceta dhe Qofte zgate. Per mangësit e konstatuara ju dha masa PARALAJMERIM. Rezultati i analizave për mostrat e marra kane rezultuar brenda normave për E. Coli për te 4 produktet.	Pa Tarifë
20	05.04.2018	Denoncim në lidhje me tregtimin e produkteve shtazore (peshk) në rrugë, pa kushtet e përshtatshme, në qytetin e Korçës	DRAKU Korçe	Vijon monitorimi për konstatimin e qytetarit	Pa Tarifë
21	10.04.2018	Emri Subjektit: Florina fezaj Qarku: Qarku i Tiranës Adresa: Tirane Përshkrimi: "Pavaresisht se i është bllokuar prodhimi nga Draku ,vazhdon pa asnje shqetesim te prodhoje dhe tregtoje ne kundërshtim te ligjit"- shprehet qytetari	DRAKU Tiranë	Trajtuar dt. 24.04.2018 I është bërë zhblokimi aktivitetit, pasi ka plotësuar detyrat e lena.	Pa Tarifë
22	11.04.2018	ankese në lidhje me kushtet e papershtatshme ku tregtohen produktet (buka tregtohet pa ambalazh, cilesi e bukes shume dobet, produkte te skaduara - keshtu u shpreh qytetarja). Adresa: Market Riseldi , Rruga Siri Kodra (Perballe Hotel Meridian) Tirane	DRAKU Tirane	Trajtuar me date 13.04.2018	Pa Tarifë
23	11.04.2018	Komisiariati Digjital denoncimi i ardhur nga nje qytetar i qytetit te Delvines ne lidhje me therjet e kafsheve ne kushte te papershtatshme. Qytetari ka dhene edhe emrat e personave qe kryejne kete aktivitet (Hariz Myftari dhe i vellai Pani Myftari). Adresa: Ne Lagjen Sinan Ballaci, Delvine	DRAKU Vlorë	Trajtuar datë: 12.04.2018 Gjatë kontrollit subjekti me administrator z.Ariz Myftari ishte i mbyllur dhe nga komunikimi me administratorin u konfirmua se është në proces ç'regjistrimi të biznesit. Në subjektin me administrator, Z. Fredi(Pani)Myftari u konstatuan kushte shumë të mira higjienike e infrastrukurore. Në subjekt u gjeten në proces shitje 5 karkasa mish qengji të vulosura dhe të çertifikuara nga veterineri i pushtetit lokal (Bashkia Sarandë çertifikata e dt. 06.04.2018 me 16 krerë të therura) dhe ¾ karkasë mish derri i vulosur dhe çertifikuar (çertifikata nr.14,dt.04.04.2018 nga thertorja Sarandë). Gjithashtu u bë monitorimi i imtësishëm i ambienteve përreth ketyre subjekteve (bahçe,depo etj) dhe nuk u konstatuan shenja të therjeve të bagëtive në ditet e mëparshme.	Pa Tarifë
24	12.04.2018	denoncim nga nje qytetar ne lidhje me tregtimin e produkteve shtazore qe behen ne kushte teresisht te papershtatshme higjieno-sanitare. Adresa: Kamez, Tirane	DRAKU Tiranë	16.04.2018 Nisur nga denoncimi i qytetarit nga Kamza për tregtim të peshkut në rrugë, tek tregu Kamez me date 22.03.2018 trupa inspektuese DRAKU Tirane te cilët bene inspektimin ne kete zone duke bashkëpunuar edhe me policine Bashkiake te Kamzes. Gjate inspektimit nuk u konstatua tregtim te peshkut ne rrugë me karroca apo ndonje makine qe tregtonte peshk ne ambient te hapur.Monitorimi i këtij tregu do vazhdoje edhe ditet e pushimit (Te shtunen dhe te djelen)	Pa Tarifë
25	17.04.2018	Ne vazhdimësi te korrespondences me nje qytetare nga fshati i Drenovices edhe pas kthim pergjigjes nga ana e AKU-se, është dërguar perseri mesazh ditën e sotme në faqen e Facebook te AKU-se në lidhje me fenomenin e shitjes se produkteve ushqimore ne kushte jo te pershtatshme.	DRAKU Berat	Trajtuar datë 27.04.2018 Drejtoria Rajonale e AKU Berat ka bërë verifikime në terren në datat 19.04.2018 dhe 20.04.2018 referuar fotos të dërguar nga Ju ku është identifikuar vendndodhja e saktë e objektit në foton e mundësuar, por nuk është konstatuar asnjë tavolinë dhe asnjë mjet tjetër ku mund të tregtohen produkte ushqimore. Për sa me lart lidhur me rastin në fjalë nga ana e DRAKU-Berat do të kryhen monitorime dhe verikime të tjera në ditët në vazhdim me qëllim shmangien e rasteve të tregimit të produkteve ushqimore në kushte të pa përshtatshme.	Pa Tarifë

26	20.04.2018	Njoftim nga Mbrojtja e Konsumatorit ne lidhje me nje rast helmimi qe ka ndodhur ne Tirane prane shkolles Azef Pellumbi. Dyshimi se vajza, nxënëse në klasën e 9, në shkollën At Zef Pëllumbi, ka konsumuar një sanduic të cilin e ka blerë në subjektin Sindi Kryemadhi	DRAKU Tiranë	Trajtuar datë 25.04.2018 Nga konstatimet e mësipërme trupa inspektuese e AKU-së ka marrë vendimin: U mor masa urgjente e ndërprerjes së veprimtarisë deri në plotësimin e kërkesave ligjore. Bazuar në Ligjin Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar), për shkeljet e konstatuara, në kundërshtim me nenin 23 “Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës së ushqimeve”, neni 36 “Kërkesa të përgjithshme të etiketimit të ushqimit”, neni 25 “Kërkesat për gjurmueshmërinë e ushqimeve”, për kundrvajtjet administrative dënohet me gjobë, sipas nenit 68 “Kundërvajtjet administrative”, pika 1: gërma h) Çdo veprim në kundërshtim me kushtet e higjienës së ushqimeve, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji, me 300 000 (treqind mijë) lekë. gërma i) Çdo veprim në kundërshtim me kërkesat e gjurmueshmërisë, të përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji, me 100 000 (njëqind mijë) lekë.	Pa Tarifë
27	23.04.2018	Denoncim ne lidhje me date e skadences se produktit Tëix qe tregtohet ne marketin Big Market ne Vlore. Bazuar ne foto vazhdon tregtimi i ketyre produkteve edhe pse data e skadences eshte me 01.04.2018. Adresa sipas Kuponit Tatimor: Big Porti shpk Rruga Kosova Pallati 11 Katesh Nipt: L56727203N	DRAKU Vlorë	Trajtuar datë 24.04.2018 gjendje në subjekt janë 23 copë me kod Bar: 000159384476, Afat 03.06.2018, lot: 744E2NLD050, Faturë blerje: subjekti INTERBRANS: serie 217757827 datë 03.03.2018, sasia e blerë 72 copë. U kontrolluan dhe evidencat e shitjes dhe kartela e Magazinës për këtë produkt, ku rezultoi se nuk ka blerje të tjera të produktit TËIX pas datës 03.03.2018. Vendimi: Në zbatim të Ligjit Nr 10433 dt 16/06/2011 "Për inspektimin në RSH" neni 47 inspektimi është kryer i plotë dhe në subjekt nuk u konstatuan shkelje të legjisllacionit në fuqi.	Pa Tarifë
28	27.04.2018/ 30.04.2018	tregtimin e produktit miell (i cili ka rezultuar i skaduar) Subjekti Fudi, Kthesa e dyte e rruges per ne Sharre, (ne te djathte kur vjen per ne Durres) Rruga nacionale Kombinat- Plepa (rruga e Ndroqit), perballe me FNSH	DRAKU Tiranë	Trajtuar datë 08.05.2018 Më datë 30.04.2018 nga trupa inspektuese e Drejtorise Rajonale te AKU- Tiranë, u krye inspektimi në subjektin “DK-Ledio”, me administrator Z. Petrit Kodra me NIPT/NUIS: L21407026J, me aktivitet: “Magazinin dhe tregtim miell dhe drithrash” dhe adresë: Ish Shkolla e Edukimit, Vaqar, Tiranë, ku gjatë kontrollit të ushtruar është konstatuar se: Në ambientet e këtij subjekti magazinohet dhe tregtohet produkti Miell Tirana dhe nuk rezultoi produkt tjetër miell me thasë me afat perdorimi 07.04.2018 dhe 04.03.2017, sikurse është paraqitur ne fotot e ardhura nga denoncuesi. Në magazinë ndodhet gjendje në momentin e inspektimit produkt Miell Tirana me datë skadence: 22.03.2019; 24.04.2019; 23.04.2019; 19.04.2019. (shoqëruar me fatura tatimore shitjeje nga Mielli Tirana sh.a dhe raport provat e autokontrollit nga ky subjekt).	Pa Tarifë
29	30.04.2018	Subjekt, aplikon për hapjen e një biznesi, Pretendon se po pengohet në fillimin e punë shprehet "sipas bisedes qe patem ne zyrat tuaja, duam te denoncojme rastin tone duke menduar qe po shkelen te drejtat tona dhe po pengohet fillimi i punes me qellim".	DPAKU	30.04.2018 Personi u ftua ne zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme AKU për sqarime të mëtejshme në lidhje me rastin dhe u realizua takimi.	Pa Tarifë
30	08.05.2018	Produkte të pasigurta Subjekti: Market "Marvi&Soni". Adresa: ne Tirane rruga Myrteza Topi, pallati 18 ne katin e pare, ne afersi te rruges se Barrikadave.	DRAKU Tiranë	Trajtuar datë 15.05.2018 Në ambientet e këtij subjekti janë konstatuar produkte ushqimore (biskota, amareta, krem çokollatë, supa, etj, në sasinë total 3720 gr) me afat përdorimi të kaluar, të cilat u bllokuan dhe u asgjësuan në vend nga trupa inspektuese sipas kërkesave ligjore. Ndaj subjektit bazuar në Ligjin Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar), për shkeljet e konstatuara, sipas nenit 68 “Kundërvajtjet administrative”, pika 1 gërma d) Nxjerrja në treg e ushqimeve në kundërshtim me pikën 2 të nenit 10 të këtij ligji, u mor masa administrative gjobë me vlerë 300 000 (treqind mijë) lekë. Gjithashtu ndaj tij u mor masa administrative Paralajmërim dhe urdhërim i subjektit për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara brenda fatit të përcaktuar.	Pa Tarifë

31	11.05.2018	Një qytetar ngre shqetesimin ne lidhje me cilesine e miellit, kontrollet, analizat (duke u bazuar ne emisionin investigativ te dhene mbremjen e dates 07.05.2018	DPAKU	15.05.2018 Gjate analizimit te mostrave ne zbatim te Urdherit Nr. 2453 date 04.04.2018 Per "Marrjen e mostrave per analizim te treguesit proteine ne produktet "Grure" dhe "Miell" per cdo ngarkese ne PIK-Morine dhe PIK-Hani Hotit": Niveli i proteins per mostrat e analizuar eshte ne perputhje me normen e deklaruar ne dokumentacionin shoqerues. AKU ju falenderon, pasi cdo informacion, apo shqetesim qe paraqitni na ndihmoni ne misionin qe AKU ka.	Pa Tarife
32	13.05.2018	Denoncim ne lidhje me produktin oriz qe tregtohet nga Firma Gold e Teutes. Qytetarja pretendon se orizi qe tregtohet eshte oriz plastik dhe ngre shqetesimin mbi demin qe mund te shkaktoje konsumimi i tij nga qytetaret (sidomos te femijet).	DRAKU Durrës	23.05.2018 Orizi gold Klasik është importuar nga Spanja nga vetë subjekti Teuta shpk dhe sasia e importuar është e shoqëruar me: certifikatë origjine/Euro 1, certifikatë fito-sanitare dhe certifikatë cilësie nga subjekti eksportues Spanjoll. Gjithashtu ky produkt shoqërohej me raport prova përkatësisht: autokontroll nga vetë subjekti si dhe kontroll zyrtar gjatë procedurave të importit, analizuar në laboratorin rajonal të Durrësit për treguesit fiziko kimikë dhe organo shqisor të cilat kanë rezultuar brenda normave të lejuara. Në ambientet e këtij subjekti u gjet gjendje e produktit orizi gold klasik dhe mor mostër për analizë e cila u dërguan në laboratorin Rajonal të AKU Durrës. Nga raport prova nuk kostatohen parregullsi pasi treguesit fiziko kimike kanë rezultuar brenda normave të lejuara, pa dëmtues dhe pa lëndë të huaj.	Pa Tarife
33	14.05.2018	Denoncim për fenomenin e shitjes se produkteve ne kushte jo te pershtatshme. Adresa: Drenovice Berat	DRAKU Berat	18.05.2018 Referuar shqetesimit te derguar nga Ju ne lidhje me tregtimin e produktit kumbulla ne kushte te papershtatshme, inspektoret e Drejtorise Rajonale AKU Berat, kane bere verifikim ne daten 17.05.2018 prane shkolles "Zenele Zeka" dhe nuk kane konstatuar tregtues te produkteve ushqimore. Trupa Inspektuese do te jete ne monitorim te vazhdueshem te kesaj zone.	Pa Tarife
34	21.05.2018	denoncim ne lidhje me kushtet e papershtatshme te bodrumit te pallatit ku jetojne, ka aktivitet edhe nje katering. Adresa Rruga Gjon Buzuku (pallati Edale), Tirane.	DRAKU Tiranë	21.05.2018 Nga inspektimi i kryer ne subjekt u konstatuan disa mangësi për te cilat ndaj subjektit u mor masa administrative gjobe ne vlerën 110.000 leke (për mos implementim te planit HACCP u mor masa administrative me gjobe 100.000 leke dhe për mos realizim te detyrave te inspektimit paraardhës masa administrative me gjobe prej 10.000 leke).	Pa Tarife
35	21.05.2018	Denoncim ne lidhje me tregtimin e produkteve te pasigurta (hamburger, pica, akullore etj.) , jashte kushteve te pershtatshme, prane shkolles 9 vjecare Sevasti Qirjazi.	DRAKU Korce	23.05.2018 Trupa inspektuese nga Drejtoria Rajonale e AKU Korce (sektori OJSH) ka kryer ditën e djeshme date 22.05.2018 inspektim ne subjektin Erjon Qafzezi .Subjekti u inspektua dhe nga inspektoret nuk u konstatuan shkelje te legjislacionit ne fuqi . Subjekti kryente aktivitet si njesi tregtimi dhe nuk u konstatuan produkte hamburger dhe pica (sipas denoncimi te ardhur).	Pa Tarife
36	22.05.2018	ankese ne lidhje me tregtimin e produkteve jo te sigurta (kos frutash te prishur, produkte ne banak me mungese etikete) ne subjektin me emer Violeta Hoxha (market) . Adresa: ne fund te Materniteti i Ri (pallati perbri) (pas bllokut te pallateve te vjetra).	DRAKU Tiranë	23.05.2018 U krye verifikim nga Trupa inspektuese e Drejtorisë Rajonale te AKU Tirane ne subjekt dhe rezultoi se ne momentin e kontrollit nuk u konstatuan problematikat (si prani kos frutash te prishur, apo produkte te vendosura ne banak me mungese etikete) Gjithashtu u be verifikimi i te gjithë afateve te përdorimit për produktet e tjera ushqimore dhe nuk u konstatuan probleme.	Pa Tarife
37	24.05.2018	Denoncim i ardhur nga nje qytetar ne lidhje me tregtimin e produktit (oriz) i cili eshte me insekte. (ka dërguar video) Produkti Oriz Golden Sun nga Kompania Apollon 5 shpk	DRAKU Tiranë	31.05.2018 OBU disponon raport analizë të produktit oriz. Në shkurt të 2018 është marre mostër për kontroll zyrtar dhe pergjigja e analizës është brenda normave të lejuara. Etiketat për produktin oriz janë të notifikuara. Gjurmueshmeria funksionon. Për qëllim të inspektimit në subjekt u mor mostër oriz "Golden Sun" për analiza pranë laboratorit të DRAKU Tiranë. Përsa më lartë u morën këto masa: 1-Ne zbatim të nenit 43, pika 1, germa (b) si dhe në zbatim të nenit 43, pika 2, germa (ç) produkti oriz"Golden Sun" e ambalazhuar në pako 1kg, në sasinë 3790 kg bllokohet deri në daljen e rezulttit të analizave. 2-Ne zbatim të pikave 1,2,3,4 te nenit 38 te ligjit 10433 date 16.06.2011" Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Për qëllim të inspektimit u bë marrja e mostrave për analiza fiziko kimike pranë laboratorit të DRAKU Tiranë.	Pa Tarife

38	31.05.2018	Denoncim ne lidhje me produkte te prishura (peta byreku me myk) , edhe perse tregtohen brenda dates se skadences. Adresa : Big Market ne rrugen Njazi Meka, Tirane.	DRAKU Tiranë	06.06.2018 U bë verifikimi në subjekt i kushteve higjieno sanitare të përgjithshme te përshtatshme, sistemimi i paisjeve sipas procesit të punës që kryhet, dhe aspirimi të përshtatet sipas këtij procesi pune, personeli me libreza shëndetësore, 1 librezë në procedurë rinovimi, disponon dokumentacion shoqëruar për lëndën e parë dhe produkt i gatshëm, disponon analizën mikrobiale të ujit të rrjetit dhe shërbimin 3D. Nuk ka etiketë të notifikuar për produktin e gatshëm petë. Përdor ambalazh të përshtatshëm për ushqim. Nga sa më lart, nga trupa inspektuese e AKU-së u mor vendimi: a.Bazuar në ligjin nr.9863 dt .28.01.2008 “Për ushqimin” (i ndryshuar), neni 68 (kundravajtjet administrative) pika 1, gërma k të këtij neni (etiketimi në kundërshtim me nenin 36) OBU i jepet masa administrative gjorbë me vlerë 50000 (pesëdhjetë mijë) lekë. b.Bazuar në ligjin 10433 dt.16.06.2011 “Per inspektimin në RSH “ neni 48 pika 1,4,5 Obu i jepet masë administrative “Paralajmërim” dhe i lihet afat kohor për korigjim të mangësive të konstatuara deri ne 20.06.2018 dhe të njoftojë pranë DR AKU Tiranë. Subjektit i lihet detyrë të mos tregtojë produkte me etiketë të pa notifikuar.	Pa Tarifë
39	07.06.2018	shqetesim ne lidhje me tregtimin e produktit domate me pesticide ne tregje.	DPAKU Sektori OJSH	07.06.2018 AKU kryen kontrolle zyrtare bazuar ne Planin e inspektiveve me baze Risku (miratuar nga Ministri) ku objekt kontrolli jane edhe subjektet qe tregtojne zarzavate, fruta dhe perime me pakice/shumice. Sa me lartë, lidhur me përgjigjet e rezultatit të analizave të mostave të dërguara në ISUV për analizim të përbajtjes së pesticideve në zbatim të Udhëzimit Nr. 9 datë 11.04.2017, Ju bëjmë me dije se: Te gjitha mostrat e analizuaru kane rezultuar brenda normave te lejuara. Gjithashtu referuar informacioneve të ardhura nga Sektori i Koordinimit të Laboratoreve nuk ka patur asnjë raportim të menjëhershëm për raste pozitive për vitin 2017 nga ISUV.	Pa Tarifë
40	11.06.2018	denoncim nga nje qytetar ne lidhje me kushtet higjieno-sanitare ne subjektin Stefan Nika, ne adrese, rruga Sali Butka, Tirane.	DRAKU Tiranë	10.09.2018 Subjekti Stefan Nika me NIPT, L72303023M ne adresen Rr. Shefqet Musaraj (Rr.Sali Butka) dhe aktivitet Restorant (gjelltoe) eshte inspektuar me date 06.09.2018 . Gjate inspektimit u konstatua: 1. Mungon garderobera 2. Sistemimi i produkteve ne frigorifer jo sipas natyres se tyre 3. Raport analizat per disa produkte te pa rinovuara. Per mangesit e kostatuara ju dha masa administrative PARALAJMERIM.	Pa Tarifë
41	07.06.2018	denoncim ne lidhje me tregtimin e produkteve te pasigurta. Behet fjale per produktin (komposto kumbulle) e cila prodhohet nga subjekti Sidnej shpk (qarku Berat).	DRAKU Berat	08.06.2018 Nga verifikimi në ambientet e magazinave të subjektit nuk u konstatua gjendje produkti “Komposto Kumbulle” (580 g). Nuk u konstatuan lëndë të para, pasi sezoni i përpunimit të këtij produkti për këtë vit nuk ka filluar akoma. Produkti Komposto kumbulle i prodhuar nga sezoni i viti të kaluar është i shoqëruar me raport prove Nr. 251 datë 20.02.2018 dhe ka rezultuar konform standardeve. Gjurmueshmëria për shpërndarjen e produktit funksionon. Ky operator I biznesit ushqimor (OBU) disponon kartën teknologjike për prodhimin e produktit “komposto kumbulle”.	Pa Tarifë
42	11.06.2018	Zona: Yzberisht Rruga : Nela Nr i Shtepis : 15 Shtepi 3 kateshe Dyshimi se përdoret banesa e shtëpisë për përgatitjen e produkteve fast-food	DRAKU Tiranë	Trajtuar me date 12.06.2018 dhe 01.07.2018	Pa Tarifë

43	22.06.2018	Denoncim ne lidhje me tregtimin e produktit te pasigurt (pasta shu e mykur). Produkti tregtohet ne subjektin, furra e bukes Dumrea, me NIPT: L71509010S Adresa sipas Kuponit Tatimor: Rruga Rrapo Hekali, Zona Selite, Vila Nr. 176, Kati 1	DRAKU Tiranë	03.07.2018 Në subjekt nuk u konstatua në momentin e inspektimit produkt pastashu. Nga kontrolli në ambientet e subjektit rezultoi se produktet e pasticere nuk prodhohen në këtë adresë, por vetëm tregtohen. Kushtet e ruajtjes së produkteve të pasticere janë të pershtatshme (në kushte frigoriferike). Në bazë të gjurmueshmerisë sipas faturave të shoqerimit për produktet e pasticere rezultoi se këto produkte prodhohen në furrë buke & pasticeri të të njëjtit subjekt me adresë rruga Robert Shvarc. Në vijim të ndjekjes së problematikës u nxorë autorizimi me nr çeshtje 001875-2/1 për kryerjen kontrollit në subjektin 'DUMREA' në adresën Rr.Robert Shvarc nga ku u konstatua se: Në bazë të gjurmueshmerisë për produktin e pasticere (pastashu me myk sipas denoncimit) në momentin e inspektimit ka gjendje 4 copë pastashu për të cilat me shikim te lire nuk u konstatuan shënja myku. Për analizim më të plotë u morë mostër "Kontroll Zyrtar"si dhe u bë bllokimi i veprimtarisë prodhuese të produktit të pasticere (pastashu) deri në daljen e përgjigjes së analizës. Ne vijim te ndjekjes se denoncimit te ardhur me email mbi produktin pastashu ju bej me dije se, referuar raport proves nr. 357/298 date 2906.2018 e cila ka rezultuar brenda normave te lejuara (pa prani te mykut ne brendesi dhe ne sipërfaqe), u be zhbllokimi i linjes se prodhimit te produktit pastashu.	Pa Tarifë
44	25.06.2018	Denoncim për tregtimin e produkteve bulmet dhe peshk jashte kushteve higjieno-sanitare. Adresa: Tregu Petrele, prane ish stacionit te Trenit, Tirane. Qytetari shprehet se ne momentin qe ka kontrole nga trupa inspektuese e AKU-se, keto subjekte mbyllin grilat, per te evituar kontrollin.	DRAKU Tiranë	27.06.2018 Ne tregun qe ndodhet ne Rr.Skender Kosturi afer ish stacionit te trenit ne Tirane nuk u gjet asnje subjekt qe tregeton bulmet. Dy subjektet qe jane mbyllur nga ana e jone dite me pare vazhdojne te qendrojne te bllokuar. U kostatua se ne nje ambient te ketij tregu tregtohej peshk nga z.Shkelqim Duka i cili ishte i pa rregjistruar ne Q.K.B. Ambienti ishte i pa pershtatshem per tregetim peshku. Kishte vetem nje banak frigoriferik dhe akull per ruajtje te produktit .Ambienti nuk ploteson asnje kusht tregtimi. Subjekti kishte 18 kg peshk te cilin ja bllokuam dhe asgjesuam. Deri ne momentin e asgjesimit te peshkut (duke ja ndotur me sasi te bollshme klori aktiv) subjekti qe bashkepunues me trupen inspektuese. Duke pare qe nuk kishte dokument identifikimi nuk kishte nipt, kontaktuam me perfaqses te tregut me te cilet rame dakort dhe nenshkruan proces verbalin qe ne kete ambient duke filluar qe sot nuk do tregtohen produkte shtazore. Kete gje e pranoi dhe personi qe u gjet duke tregtuar peshk.	Pa Tarifë
45	03.07.2018	Ne vijim te shqetesimit te shprehur edhe me pare, qytetari na ka kontaktuar perseri dite e sotme dhe shprehet se vazhdon e njejta situate. Qytetari thekson se inspektoret e AKU-se kane qene prezent ne ambientet e tregut, por ne momentin qe ata largohen, keto subjekte vazhdojne te tregtojne bulmet, peshk, byrek ne kushte te papershtatshme, pa ambient frigoriferik. Adresa : Tregu Petrele, prane ish stacionit te Trenit, Tirane. Momentalisht qytetari shprehet se jane dy subjekte qe tregtojne bulmet.	DRAKU Tiranë	Vijon monitorimi I tregut per per konstatimin e qytetarit	Pa Tarifë

46	06.07.2018	Shqetesimin ne lidhje me ushtrimin e aktivitetit te paligjshem te prodhimit te produkteve (fabrike jufkash). Qytetari pretendon se ky subjekt zhvillon aktivitetin ne mungese te dokumentacionit, si licence, kupon tatimor, nipt. Adresa: Rruga Kole Koci, Tirane.	DRAKU Tirane	09.07.2018 Referuar indicios së ardhur u krye kontrolli në subjekt ku rezultoi: OBU inspektohet për herë të parë nga AKU. Ushtron aktivitetin në një ambient me vendndodhje dhe planimetri të përshtatshme. Mjeti i transportit është i përshtatshëm. - Kushtet higjieno sanitare, ambjenti i mbajtjes së lëndës së parë ka nevojë për lysterje dhe largim sendesh të teperta, një pjesë e ambientit të përpunimit ka nevojë për lysterje, në momentin e kontrollit subjekti nuk u gjet në proces prodhimi, substancat pastruese mbahen në vend të veçantë, përdor ujë rrjeti analiza mikrobiologjike e të cilit duhet rinovuar, disponon dokumentacion shoqerues për produktin “Jufka”(raport analizë). Një pjesë e raport analizave të lëndëve të para duhen rifreskuar, ambalazhi i përdorur është i përshtatshëm për ushqim. Etiketa e produktit Jufka emdo është e notifikuar, gjurmueshmeria funksionon. Dezinfektimi i ambientit kryhet nga vete subjekti por nuk dokumentohet. Përsa më lartë Në zbatim të pikave 1 , 4 , 5 të nenit 48 të ligjit nr 10433 datë 16.06.2011’’Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë, obu i jepet masa administrative kryesore’’Paralajmerim’’ dhe korrigjim të mangësive brenda një afati kohor 15 ditor.	Pa Tarifë
47	10.07.2018	Shqetesim ne lidhje me tregtimin e produktit mish, jashte cdo kushti apo kriteri te pershtatshem. Adresa: Himare, Qeparo,	DRAKU Vlorë	11.07.2018 Grupi i inspektimit ka konstatuar (lidhur me indicien) se: Mjeti transportit (fugon Benz AA332EB frigoriferik FNA-X_09-2019 me NIPT, Sekondar Identifikimi SN-316297-07-15 dhe me kasë fiskale i perket ketij Subjekti . Subjekti ka shpërndarë produkt mish me makinën në zonën e Himarës, në datë 07.09.2018, të shoqëruar me faturë shoqërimi Nr. L7815503 dhe faturë shitje Nr. 59853209 dhe 59853210 dhe ka bërë hyrje në Magazinë pjesën e pashitur me faturë hyrje 17875553 (Nr.3), karkasat janë të vulosura dhe të çerifikuara. Vendimi: Në zbatim të ligjit Nr.10433, dt. 16.6.2011, ” Për inspektimin në R.SH”,neni 47, inspektimi është kryer i plotë dhe në subjekt nuk u konstatuan shkelje të legjislacionit në fuqi.	Pa Tarifë
48	26.06.2018	Ne rrjetin social Facebook nje qytetar ka denoncuar ne lidhje me kushtet higjieno-sanitare te nje lokali ne Shkoder.Qytetari pretendon se eshte semure pas konsumimit te ushqimit ne kete lokal dite e djeshme. Lokali quhet Te Mali. Adresa: Te ish Dega, Shkoder.	DRAKU Shkodër	12.07.2018 Trupa inspektuese DRAKU Shkodër kontaktoi se: Subjekti TEMALI është i paisur me QKR dhe zotëron certifikatë regjistrimi Person i tatueshëm Me nr identifikimi NUIS L76715004U. Kushtet dhe gjendja e stabilimentit e përshtatshme, Kushtet higjieno sanitare të përshtatshme, Disponon të gjithë dokumentacionin e gjurmueshmerisë dhe dokumentacionin shoqerues të produkteve Analizën e Ujit dhe librezat shëndetësore i ka në proces Rinovimi . Për sa më lart: subjektit i jepet dënimi administrativ “Paralajmërim” si dhe realizimin e detyrave brenda dt 05.07.2018. Subjekti detyrohet të njoftojë DRAKU për realizimin e detyrave të lëna brenda afateve të përcaktuara.	Pa Tarifë

49	29.06.2018	Ne Faqen zyrtare te AKU-se ka ardhur nje denoncim ne lidhje me tregtimin e produkteve ushqimore te pasigurta. Nje qytetar denoncon per shitjen e produkteve te mykura (torte dhe trilece) ne pasticerine Ege Bakllava. Qytetari pretendon se pas konsumimit te tyre bashkeshortja e tij eshte semure. Adresa : Rruga e Don Boskos, pasticeri Ege Bakllava, Tirane.	DRAKU Tiranë	16.07.2018 Pas kontrollit nga trupa inspektuese AKU rezultoi se: OBU ne kete adrese ushtron aktivitet te tregtimit te produkteve tw pasticerise dhe bar kafe. Kushtet higjeno sanitare “Ambjenti eshte i pershtatshem dhe i mirembajtur, produktet ruhen ne ambient frigoriferik, sipas natyres se produktit.Produktet nga ana vizuale jane te fresketa, nuk duket te kete prani myku apo te jene te ndenjura. U krye marrje mostre per dy produkte (torte , trilece) per analize enterobakter ne Laboratorin e ISUV-se. OBU i jepet denimi administrative kryesor”Paralajmerim” dhe korrigjim te mangesive brenda nje afati kohor 7 ditor. Ne vijim te ndjekjes se problematikes bazuar ne rezultatit e raport provave si dhe ne ndjekje te gjurmuesherise eshte kryer inspektimi ne adresen me aktivitet prodhim te produkteve te pasticeri nga ku furnizohet subjekti. u krye kontrolli në subjektin me perfaqesues ligjor Aslan Can Cil me NIPT: L81703043R dhe aktivitet: “Pasticeri“: Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, rruga "Muzaket", pallati 4 Gryket, nr.1, kati 1. Referuar raport proves nr 3717/2018 per produktin Torte i cili ka rezultuar mbi norme me enterobakterie, subjektit ju be bllokimi i linjes se prodhimit dhe tregtimit te produktit torte deri ne momentin qe analizat e autokontrollit te dalin ne normen e lejuar, subjekti te paraqitet prane institucionit te Aku per procedurat e metejshme. Ne perfundim te ketij kontrolli trupa inspektuese vendosi”Neni: 68 . Ligji: 9863 Per Ushqim i Ndryshuar . Pika: 1 germa d) Gjobe ne vleren 300000 (treqind mije) lek per nxjerrjen në treg e ushqimeve, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 10 të këtij ligji.	Pa Tarifë
50	10.07.2018	Denoncim ne lidhje me tregtimin e produktit mish, jashte cdo kushti apo kriteri te pershtatshem. Adresa: Himare, Qeparo	DRAKU Vlorë	11.07.2018 Grupi i inspektimit ka konstatuar (lidhur me indicien) se: Mjeti transportit (fugon Benz AA332EB frigoriferik FNA-X_09-2019 me NIPT, Sekondar Identifikimi SN-316297-07-15 dhe me kasë fiskale i perket ketij Subjekti . Subjekti ka shpërndarë produkt mish me makinën në zonën e Himarës, në datë 07.09.2018, të shoqëruar me faturë shoqërimi Nr. L7815503 dhe faturë shitje Nr. 59853209 dhe 59853210 dhe ka bërë hyrje në Magazinë pjesën e pashitur me faturë hyrje 17875553 (Nr.3), karkasat janë të vulosura dhe të çerifikuara. Vendimi: Në zbatim të ligjit Nr.10433, dt. 16.6.2011, ” Për inspektimin në R.SH”,neni 47, inspektimi është kryer i plotë dhe në subjekt nuk u konstatuan shkelje të legjisllacionit në fuqi.	Pa Tarifë
51	11.07.2018	Nje qytetar nga Burreli, parashtron problematiken ne lidhje me produktin mish tek lokalet e medha, si lokale dasmash, (produkti pa dokumentacionin shoqerues, i pasigurte). Gjithashtu kjo problematike kontaktohet sipas qytetarit edhe ne subjektet ushqimore prane Minierave te Kromit.	DRAKU Diber	Ne lidhje me subjektet jane marre masat, date 16.07.2018 duke penalizuar subjektet e minierave te cilat kishin dhe ushqim social per punonjesit e tyre, duke bere te mundur pezullimin e aktivitetin per tre subjektet dhe mase gjobe ne vleren 5 000 000 per secilin subjekt.	Pa Tarifë
52	14.07.2018	Denoncim ne lidhje me nje stabiliment perpunimi ushqimesh . Qytetari dyshon në mosplotesimin e standarteve. (Fast-Food brenda nje banese private). Adresa: Zona Yzberisht, rruga Nela	DRAKU Tiranë	17.07.2018. Pas kontrollit nga trupa inspektuese AKU u konstatua se personi qe ushtronte aktivitet Z.Anesti Aliaj, operonte me kete aktivitet i paregjistruar ne QKB (pa nipt). U Konstua se ambjenti ishte i kufizuar, mungonin kushtet higjeno sanitare, dokumentacioni shoqerues etj. Menjehere u mor masa e nderprerjes se kryerjes se veprimtarise dhe u bllokuan e konfiskuan pajisjet me prani ndryshku dhe magazinohen ne ambientet e DRAKU Tirane. Per rastin ne fjale njoftohet me shkrese zyrtare Hetimi Tatimor dhe Sektori i Krimit Ekonomik.	Pa Tarifë
53	17.07.2018	Denoncim per nje restorant te kompleksi Delijorgji "The may flower" restorant bar per mungese te kushteve higjieno-sanitare.	DRAKU Tiranë	20.07.2018 Pas kontrollit te kryer rezutoi se: Kushtet higjeno-sanitare jane të mjaftueshme. Përsa më lartë u mor masa me paralajmërim dhe korrigjimin e detyrave brenda një afati të përcaktuar, në zbatim të pikave 1, 4, 5 të nenit 48, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “ Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”	Pa Tarifë

54	17.07.2018	Ne rrjetin social te AKU-se Facebook ka ardhur nje denoncim nga nje qytetar i cili brenda produktit te blere (sallam) ka gjetur nje material plastik. Produkti i blere: marka Arani	DRAKU Tiranë	23.07.2018 U krye verifikimi i proceseve te punes dhe dokumentacionit vertetues nga ku rezulton se : 1. OBU kryen kontrollin e lendes se pare dhe produkteve ndihmese (kontroll fizik/vizual dhe dokumentacionit shoqerues), 2. Kontrollin e proceseve te prodhimit, ambllazhimit, magazinimit dhe shitjes se produktit te gatshem. 3. U krye kontroll fizik duke hapur disa pako te produkteve te gatshme si qofte, sallam nga ku nuk konstatohet prezence e trupave te huaj si material plastik. Produkti i gatshem eshte i shoqeruar me raport analize.	Pa Tarifë
55	19.07.2018	Denoncim per furre buke Laura. Adresa: Ne rrugen Luigj Gurakuqi, ne TIRANE. Sipas qytetarit Produktet dhe nenproduktet e brumit shiten jashte kushteve higjieno-sanitare.	DRAKU Tiranë	25.07.2018 Pas kryerjes se inspektimit u konstatua se: OBU funksionon ne këtë adresë si pikë tregtimi buke dhe ëmbëlsirash. Në këtë ambient nuk kryhet proces prodhimi (nuk ka asnje pajisje për këtë aktivitet). OBU disponon dokumentacion shoqerues për produktin "Buke masive" dhe "Embelsire"(raport analize) nga prodhuesi që është po i njëjti subjekt "Luara" por me adrese Rr: Him Kolli" dhe Rr. Myslym Shyri. kushtet ne te cilen kryhet aktiviteti jane te pershtatshme. Ne perfundim OBU i jepet denimi administrative kryesor "Paralajmerim" dhe korrigjim të mangesive deri në datën 31.07.2018	Pa Tarifë
56	24.07.2018	Denoncim per Embeltoren Akropoli per produkte te pasigurta , me prani myku. Adresa ne Rrugen e Elbasanit.	DRAKU Tiranë	27.07.2018 Gjate kryerjes se kontrollit ne subjekt u konstatua se: Ne kete ambient kryhet aktiviteti i tregimit te produkteve te pasticerise, nuk kryhet prodhim. Produktet merren nga pika kryesore e prodhimit te shoqeruara me dokumentacion (fature shoqerimi). Produktet ruhen ne kushte te pershtatshme frigoriferike. Eshte kryer analizimi i produkti i ci ka rezultuar. Persa me larte u mor masa me paralajmerim dhe korrigjimin e mangesive brenda nje afati te percaktuar ne zbatim te pikave 1, 4, 5 te nenit 48 te ligjit 10433, date 16.06.2011 Per Inspektimin ne Republiken e Shqiperise.	Pa Tarifë
57	23.07.2018	Denoncim per nje market ne zonen e Gjirit te Lalzit, sipas qytetarit ka produkte te skaduara. Market Reom	DRAKU Durrës	24.07.2018 Gjate inspektimit u konstatuan disa mangesi ne plotesimin e dokumentacionit te produkteve per te cilat u moren masat e meposhtme: Paralajmërim për korrigjimin e mangësive deri me datë 04.08.2018; bllokimi i produkteve ushqimore të paetiketuara edhe në gjuhën shqipe; Në zbatim të Ligjit Nr.9863 datë 28.01.20008 "Për Ushqimin" i ndryshuar Neni 68, Pika 1, gërma k u mor masa administrative gjobë me vlerë 100.000 lekë.	Pa Tarifë
58	25.07.2018	Denoncim mbi cilësinë e produktit buke ne furrën e bukës "Luara" me adresën Rruga Luigj Gurakuqi Tirane.	DRAKU Tirane	07.08.2018 Menjehere u krye kontrolli nga trupa inspektuese ku u konstatua: Subjekti ushtronte aktivitetin në planimetri, ambient dhe kushte higjieno- sanitare te pershtatshme për natyrën e aktivitetit. Gjithashtu u mor mostër buke masive dhe u dërgua për analizim ne Laborator nga ku rezultoi brenda normave te lejuara. ushtrroi kontrolle edhe ne dy adresat e subjektit "Luara" ku rezultoi se lënda e pare për prodhimin e bukës (miell gruri) konkretisht niveli I proteinës qe përdorej bazohet ne udhëzimin e MBZHR.	Pa Tarifë
